



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1320/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Ridvan Shaqiri në cilësinë e vëzhguesit nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjilan, paraqitur kundër Halim Rrudhanit nga subjekti politik Partia e Drejtësisë (PD), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhorë për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**HIDHET** si e parregullt ankesa e Ridvan Shaqirit, në cilësinë e vëzhguesit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjilan.

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 24.12.2013 ka pranuar një ankesë, nga Ridvan Shaqirit, në cilësinë e vëzhguesit nga subjekti politik PDK dega në Gjilan me të cilën pretendon se Halim Rrudhani nga subjekti politik PD në cilësinë e komisionarit ka bërë shkelje duke i sugjeruar votuesit për kë të votojnë pas tërheqjes së vërejtjes nga ana e tij ai është kërcënuar dhe i është kërkuar nga Halim Rrudhani që ta braktis dhomën.

PZAP-i, shqyrtoi rregullsinë e ankesës, gjeti se:

### Ankesa është e parregullt

Nga shkresat e lendes PZAP-i konstatoi se ankesa është e parregullt sepse nuk i plotëson kushtet e parapara në nenin 3.6 pika d të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më të cilën dispozitë kërkohet vërtetimi nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës.

Parregullsitë e ankesës qëndrojnë në atë se parashtresuesi i ankesës nuk e ka nënshkruar fare ankesën, që është në kundërshtim me dispozitën e lart theksuar.

Prandaj bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në bazë të nenit 118.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1320/2013 më datën 27.12.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



**Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.